

VENDIM
Nr. 112, datë 17.11.2023

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE
“TË RINJTË DHE TË REJAT DREJT NJË PROFESIONI”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|----------|
| - z. Ervin Mete | kryetar; |
| - znj. Mimoza Dhëmbi | anëtare; |
| - znj. Brikena Qela | anëtare; |
| - znj. Inida Methoxha | anëtare; |
| - z. Ahmet Maçellari | anëtar, |

në mbledhjen e tij të radhës të datës 17.11.2023, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Tiranë, lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 22293, datë 14.6.2023, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në përputhje me draftudhëzuesin operacional të projektit “Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni”, i cili do të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me shkresën nr. 10972/1, datë 18.7.2023, i kërkoi Bashkisë Tiranë një informacion shtesë mbi përshkrimin dhe zbatimin e projektit. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 22293/2, datë 25.8.2023, ka dërguar pranë MFE-së të dhënat e kërkuara.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objektivi*: projekti “Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni” synon të krijojë lehtësi për punësimin e të rinjve dhe të rejave të sapodiplomuar për profesionet e studiara nëpërmjet bashkëpunimit me subjektet private.

3. *Vlera e ndihmës dhe baza ligjore*: plani i ndihmës shtetërore është hartuar në bazë të draftudhëzuesit operacional të projektit “Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni”, i cili do të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë. Ndihma do të jepet në formën e grantit në vlerën 12.000.000 lekë, në përputhje me vendimin nr. 23, datë 17.3.2023, të Këshillit Bashkiak të Tiranës, “Për disa shtesa dhe ndryshime për vendimin nr. 126, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak, ‘Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023–2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023’”, nën programin e kujdesit social për projektin “Të rinj dhe të reja drejt një profesioni”. Shpenzimet e pranueshme që do të mbulohen nga ndihma përfshijnë: pagën minimale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

4. *Kohëzgjatja*: plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2023–2024.

5. *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. *Përfituesit*: përfitues do të jenë të rinjtë dhe të rejat deri në 29 vjeç, që janë banorë rezident në Bashkinë Tiranë, që kanë më pak se 12 muaj që kanë përfunduar studimet universitare, brenda apo jashtë vendit, me rezultate të larta dhe rezultojnë të papunë. Zbatimi i skemës do të mundësojë punësimin me kontratë të 43 përfituesve me afat të caktuar 6-mujor.

7. *Shtrirja territoriale*: projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

8. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave përbën ndihmë shtetërore, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje; ka ndikim potencial në konkurrencë dhe tregti në rajon; që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

9. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoq formë, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara, ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

10. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87, të traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

11. Sa më lart, ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, më konkretisht: a) burime shtetërore, b) avantazhi ekonomik, c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

12. Plan i njoftuar i ndihmës shtetërore aktivizon burime shtetërore në formën e grantit të planifikuar dhe miratuar për Bashkinë e Tiranës, për të kompensuar të rinjtë për pagën që do të marrin për punën e kryer në masën e pagës minimale, përfshirë kontributet e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Masa ofron avantazh ekonomik, duke qenë se objektivi i saj është mbështetja me burime shtetërore për mbulimin e kostos së pagës për të rinjtë e punësuar. Skema është selektive, pasi do të akordohet vetëm për punëdhënësit e përzgjedhur pas mbylljes së procedurës së aplikimit. Masa ka efekt në konkurrencë, sepse përfshin të gjithë sektorët e ekonomisë dhe ndërmarrjet aktive në sektorë që janë të hapur për konkurrencë dhe tregti ndërkombëtare.

Në këto kushte, komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore, e cila në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

13. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, i cili parashikon:

“Ndihma “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”.

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “de minimis”, vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës de minimis përcaktohen si vijon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi.

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Në kreun III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”, të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: “1 Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”.

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr. 605/2016, ndihma “*de minimis*” lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (*katërmëdhjetë milionë*) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet duke qenë se ndihma shtetërore për një ndërmarrje është në vlerën e pagës minimale bruto;

b) ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 2 vite, duke plotësuar këtë kusht ligjor;

c) ndihma është transparente. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e planit të ndihmës shtetërore në formën e grantit, të miratuar me vendimin nr. 23, datë 17.3.2023, të Këshillit Bashkiak të Tiranës, “Për disa shtesa dhe ndryshime për vendimin nr. 126, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak, ‘Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023 – 2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023’”, nën programin e kujdesit social për projektin “Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni”.

2. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruaj Deklaratën e Ndhmës “*de-minimis*” dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë Bashkisë Tiranë.

3. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e kryera dhe rezultatet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e planit të ndihmës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të këtij plani.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ervin Mete